



GJYKATA THEMELORE FERIZAJ Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtari Misin Frangu me sek.juridike Albana Ajvazi, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit [redacted] nga Vitia rr. [redacted] "pn., kundër të paditurëve [redacted] nga [redacted] rr. [redacted]", I.Nr. [redacted] Komuna Smederev, të cilin me autorizim e përfaqson [redacted] nga Vitia rr. [redacted] pn.dhe [redacted] rr. [redacted] nr. [redacted] Smederev, me baza e juridike, vertetim i të drejtës së pronësisë, jashtë seancës gjyqore me datën 31.08.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M
-pa shqyrtim kryesor të çështjes-

I.APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditsit [redacted] nga Vitia rr. [redacted] "pn., dhe i njihet e drejta e pronsisë në ngaster kadastrale-njësën me nr. P-70101007-02758-0 , në vendin e quajtur "Smonica Duboka Brazda", me sipërfaqe 4008 m2, lloji i shfrytzimit te parcelles bujqesore, shfrytzimi aktual i parceses are, kualiteti i klases, are e klasit 3, e evidentuar në çertifikatën mbi pronësin 2253/2018, Zona Kadastrale Viti, në bazë të shitblerjes dhe mbajtëses.

II.DETYROHEN të paditurit [redacted] ishë nga Vitia, tani me vendbanim në [redacted] rr. [redacted], nr. [redacted] Komuna Smederev, dhe [redacted] ish nga Vitia tani me vendbanin në rr. [redacted] nr. [redacted] Smederev, të i'a njohin të drejtën e pronsisë paditësit [redacted] nga Vitia rr. [redacted] "pn.dhe të durojnë që ngastra e lartë cekur kadastrale-njësia, të regjistrohet në emër të tij.

III.DETYROHET Drejtoria për Katastër, Pronësi dhe Gjeodezi në Viti, që të bëjë ndryshimin në bazë të këtij aktgjykimi.

IV.OBLIGOHET paditësi që ti paguan taksen gjyqore për ushtrimin e padisë në shumen prej 25 €, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën ërcnimin e pasojave juridike.

A r s y e t i m

Paditësi përmes padisë se ushtruar te kjo gjykat ka paraqitur se me babin e të paditureve, gjat vitit 1988 në Viti, ka lidhur kontrat mbi shitblerjen e ngastres kadastrale-njësisë me nr.2758, plani 5, skica 38, në vendin e quajtur "Smonica Duboka Brazda", arë e klasit III, në sipërfaqe prej 0.40.08 ha, e regjistruar në fletën poseduese nr.112 ZK.Viti.

E cila evidentohet në emrin e të ndjerit [REDAKTUAR] babai i të paditureve, për çmimin e shitblerjes prej 200.00 DM, për një ari, që e përmban çmimin e përgjithshëm të shitblerjes prej 8.000,00 DM, të cilin çmim paditësi si bleres ia ka paguar të ndjerit [REDAKTUAR] si shitës në tërsi. Paditësi në parcelen lëndore pas shitblerjes ka hyrë në posedim të kësaj palujtshmerie, pra pas realizimit në tërsi të kontratës mbi shitblerjene kësaj palujtshmerie dhe i pa penguar e posedon parcelen lëndore dhe e shfrytëzon mbi 20 vite, me çka janë përmbushur kushte ligjore në pajtim me Ligjin mbi Maredhenjet Juridike Pronore /LMTHJP/, për fitimin e të drejtës së pronsisë në bazë të parashkrimit fitues.

Paditësi nga gjykata ka kërkuar të bjen Aktgjykim me të cilin do të aprovohet kërkespadija e paditesit, dhe të vërtetohet se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale-njësisë me nr.2758, plani 5, skica 38, në vendin e quajtur "Smonica Duboka Brazda", arë e klasit III. në sipërfaqe prej 0.40,08 ha, e regjistruar në fletën poseduese 1112 ZK.Viti.

I padituri [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] përmes përgjegjes në padi në tërsi e pranon padien dhe kërkespadin e paditesit si të bazuar duke pasur parasysh se edhe atij si dhe të paditurit [REDAKTUAR] i është e njohur se babai i tyre tani i ndjer [REDAKTUAR] e në disa dokumente është regjistruar si [REDAKTUAR] deri sa ishte në jetë e ka tjetërsuar ngastren kadastrale 2758, në vendin e quajtur "Smonica Duboka Brazda" arë e klasit të III. në sipërfaqe prej 0.40,08 ha, e regjistruar në fletën poseduese nr.1112 ZK.Viti, i cili këtë ngastër ka shfrytëzuar dhe punuar pa kurrfar pengesash. Kjo se paditësi nuk e ka bartë ngastren lëndore në emrin të vet, konsideroj se arsyeja është se në kohën e lidhjes së kontratës mbi shitblerjen ishte njëfar ndalesë e qarkullimit të palujtshmerive në Kosovë, por kontratat është lidhur dhe si e tillë është përmbushur në tërësi. Përmes përgjegjëses në padi i padituri është pajtuar që gjykata të sjellë aktgjykim siq ka propozuar paditësi në padi ashtu që nga ana tij nuk do të ketë ankese në rast se gjykata e aprovon kërkespadien sepse e njëjta është e bazuar siq e ka permendur **tanimë**.

I padituri i dytë në përgjegje në padi në tërësi e ka pruar padien dhe kërkespadija e paditesit si të bazuar duke pasur parasysh se ngastren lëndore në vendin e quajtur "Smonica Duboka Brazda" në ZK.Viti, e regjistruar në fletën poseduese nr.1112, nga kadastrale 2758 në emrin e babai tonë të nderjës [REDAKTUAR] deri sa ishte në jetë e ka tjetërsuar ngastren lëndore, babai yne tani paditesit [REDAKTUAR] edhe pse nuk me kujtohet koha e shitblerjes por e di se ishte shumë para luftës së fundit deri sa akoma ishim në fshatin Ramnisht të Vitisë.

Për këtë as unë e as vllau i im [REDAKTUAR] nuk e kontestojm të drejtën e pronësisë në parcelen lëndore paditësit bile sa me është e mua e njohur në komunukim me vllaun dhe pajtohem që paditësi të regjistrohet në parcelën lëndore të vendi i quajtur "Smonica Duboka Brazda" arë e klasit III.

Ne sipërfaqe prej 0.40,08 ha, e regjistruar në fletën poseduese nr.1112.ZK.Viti, ngastra kadastrale 2758 në emrin e [REDAKTUAR] si pronar ekskluziv sepse të njëjtën pas shitblerjës e shfrytizon dhe e punon mbi 35 vite e ndoshta edhe ma shume.

Ngastren lëndore paditesi e ka paguar në tërësi dhe e ka pranuar në posedim dhe mbajtje nga babai im i ndjerë të cilën e ka punuar pa kurrfar pengesash. Kjo se paditesi nuk e ka bartë ngastren lëndore në emrin të vet konsideroj se arsyeja është se në kohën e lidhjes së kontratës mbi shitblerjen ishte njëfar ndalese e çarkullimit të palujtshmerive në Kosovë, por kontratën është lidhur dhe si e tillë është përmbushur në tërësi. Përmes përgjegjës në padi i padituri është pajtuar që gjykata të sjellë aktgjykim siq ka propozuar paditësi në padi ashtu që nga ana tij nuk do të ketë ankese në rastë se gjykata e aprovon kërkespadien sepse e njëjta është e bazuar siq e ka permendur tanimë.

Gjykata pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës ka bërë analizimin dhe shtjellimin e provave që gjenden në shkresat e lëndës si në vijim; ka lexuar Çertifikata e pronës për ngastren kadastrale me nr.P-70101007-02758-0, ZK.Viti në emrin e të paditurit [REDAKTUAR] është lexuar Historiku i ngastres kadastrale -njësis me nr.2758 ZK.Viti, të datës 24.07.2018, si dhe kopjen e planit me nr.2253/2018 i datës 24.07.2018, lëshuar nga zyrja e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronësi në Viti, Fletën poseduese me nr.1112 ZK.Viti, ka lexuar edhe përgjegjet në padi të të paditureve.

Gjykata në vij zyrtara ka kërkuar Certifikatën e pronës-ngastres kadastrale-njësis me nr.2758 ZK.Viti, kopjen e planit dhe historikun e parcesës e cila është objekt kontesti, nga zyrja e Drejtorisë për Gjeodezi Katasren dhe Pronësi në Viti, dhe nga kjo zyre ka pranuar 1. Certifikatën e Pronës, Kopjen e Planit dhe Historikun e ngastres kadastrale-njësis, me nr. P-70101007-02758-0, ZK.Viti, e cila që nga viti 1983 evidentohet në emrin e tani të ndjerit [REDAKTUAR] ish nga Vitia.

Gjykata duke u bazuar në neni 8 të LPK-së, veçoj provat veç e veç. Çertifikatën e pronës për ngastren kadastrale-njësin nr.P-70101007-02758-0, ZK.Viti, kopja e planit, dhe Historiku i kesaj ngastre kadastrale-njësie, të cilat dëshmojnë se padia përputhet plotësisht në subjektin si palë kontestuese.

Gjykat me rastin e aprovimit të kërkespadiës së paditësit ka pasur për bazë thënjet e paditësit në padi si dhe theksimet e të të paditurëve të dhanun në përgjegjëje në padi, të cilët në tërësi e kanë pranuar se babai i tyre tani i ndjerë [REDAKTUAR] i a ka shitur ngastren kadastrale-njësin me nr. 02758-0 ZK.Viti, paditësit [REDAKTUAR] nga Vitia, i cili ka hyrë në posedim të kësaj palujtshmeri pasi e ka paguar në tërësi çmimin e kontraktuar, dhe të njëjtën e shfrytizon pa u penguar nga askush deri më tani.

Gjyaka ka vërtetuar se në mes paditësit [REDAKTUAR] dhe babait të të paditurëve [REDAKTUAR] ka egzistuar raportiti juridik i cili edhe pse i lidhur në forme jo të shkruar ka prodhuar efekt juridik, me faktin se kishte ndodhur trasanksioni në mes tyre si shitës dhe blerës. Këte rapor juridik paditësi e materializon duke hy në posedim të pa nderprerë dhe të pa penguar nga askush që nga viti 1988 ku dhe kishte paguar çmimin në tëresi.

Gjykat me rastin e aprovimit të kërkespadi së paditësit ka zbatuar dispozita ligjore të nenit 398 par.2 të LPK-së, i cili në mënyrë taksative parashef: Kur gjykata pasi të arrij përgjegjja në padi konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojne pengesat të tjera për dhënjen e vendimit meritor atëher ajo pa caktuar fare senancën gjyqesore, mundet ta jep aktgjykim me të cilen e pranon si të themeltë kërkespadinë.

Gjykata nga e drejta material konstaton se janë përmbushur kushtet nga neni 18 i LMD-së, si dhe nga neni 36 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat tjera Sendore, si dhe neni 28 parag.4, i Ligjit mbi Mardhenjet Pronsore Juridike i shpalle në G.Zyrtare të RSFJ" nr.6/80 dhe 37/90, të cilen raport edhe sot e legalizon dhe ligjitimon neni 40 parag 1 i Ligjit për të Drejtat Sendore nr.03/L-154 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Andaj Gjykata duke u bazuar në gjitha keto prova dhe fakte të pakontestueshme duke qenë i pavarur në vendosje miratoi kërkespadinë e paditësit. Shpenzimet e procedures do to bartë paditësi [REDAKTUAR] neni 467. i LPK-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të ketij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
C.nr. 431/2018 Më.31.08.2018

Sek. Juridike:
Albana Ajvazi



KËSHILLA JURIDIKE: kunder ketij Aktgjykimi munde të ushtrohet Ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së ketij Aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

